



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 11504 prot.

Vlorë, më 19.07 2024

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PËR**

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA SI DHE HUMBJEN E JETËS TË Z.GURI RESULAJ NË BANESËN E ZNJ. SOSE ZHEZHA DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E**

**BASHKISË VLORË**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Sose Zhezha, e ndodhur në lagjen “28 Nëntori”, Rajoni Nr.3, Bashkia Vlorë, në datën 02.04.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- A. 6.533(gjasht mijë e pesëqind e tridhjet e tre) lekë për punime ndërtimi. (153.955x50%).
- B. 34.572 (tridhjet e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjet e dy) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

C. Të miratojë vlerën financiare për humbjen e jetës të z.Guri Resulaj në banesën e znj.Sose Zhezha në masën :



500.000 ( pesëqind mijë ) lekë

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 11504 prot.

Vlorë, më 19.04 2024

RELACION

PËR

**PROJEKTVENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA SI DHE HUMBJEN E JETËS TË Z.GURI RESULAJ NË BANESËN E ZNJ.SOSE ZHEZHA DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA BASHKIA VLORE”**

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 08.04.2024 ka paraqitur kërkesën znj.Sose Zhezha me nr 5155 prot për shkakë të djegies së banesës dhe humbjen e jetës të z.Guri Resulaj në banesën e ndodhur në lagjen ‘‘28 Nëntori’’ Rajoni 3 Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.15 datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 11.04.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.5155/1 prot, datë 10.06.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të znj.Sose Zhezha” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.5155/2 prot, datë 09.07.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të znj.Sose Zhezha” ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e znj.Sose Zhezha është 41.105 (dyzetë e një mijë e njëqind e pesë) lekë.
- Të miratojë vlerën financiare për humbjen e jetës të z.Guri Resulaj në banesën e znj.Sose Zhezha në masën : 500.000 ( pesëqind mijë ) lekë

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Sose Zhezha sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

**DREJTOR**

**Adrian Vreshtazi**

